



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

RREGULLORE

**“PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË LICENCËS SË SHËRBIMIT
TË PROGRAMIT AUDIOVIZIV”**

*(Miratuar me Vendimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive, Nr. 2, datë 16.01.2020, dhe
ndryshuar me vendimin e AMA-s Nr. 22, datë 2.3.2026)*

**KREU I
TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Kjo rregullore në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat për:

- a. Dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv lokal dhe rajonal.
- b. Rinovimin e licencës së shërbimit të programit audioviziv lokal dhe rajonal.
- c. Zgjerimin ose ndryshimin e kushteve të licencës së shërbimit të programit audioviziv lokal dhe rajonal.

**Neni 2
Fusha e zbatimit**

Rregullat, kriteret dhe procedurat e parashikuara në këtë rregullore do të zbatohen për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv lokal dhe rajonal, rinovimin e licencës së shërbimit të programit audioviziv lokal dhe rajonal, dhe zgjerimin ose ndryshimin e kushteve të licencës së shërbimit të programit audioviziv lokal dhe rajonal.

**Neni 3
Përkufizime**

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në rast se nuk janë të

përkufizuar në ligj, do të jenë në përputhje me direktivat e BE-së dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi në fushën e mediave audiovizive.

2. Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a. “AMA” është Autoriteti i Mediave Audiovizive.
- b. “Subjekt aplikues” është personi juridik i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, i cili aplikon për marrjen, rinovimin, zgjerimin ose ndryshimin e kushteve të licencës së shërbimit të programit audioviziv lokal dhe rajonal.
- c. “Program televiziv” është tërësia e imazheve lëvizëse, me ose pa zë, që përbëjnë një element individual brenda një liste apo katalogu të krijuar nga ofruesi i shërbimit, forma dhe përmbajtja e të cilit janë të krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit televiziv. Shembujt e programeve përfshijnë filma, ngjarje sportive, komedi, dokumentarë, programe për fëmijë dhe drama origjinale.
- d. “Programe në gjuhën shqipe” janë programe të transmetuara në gjuhën shqipe, përmes titimit të programeve të huaja në gjuhën shqipe ose përshkrimit të tyre me zë në gjuhën shqipe.
- e. “Shërbim programor i përgjithshëm” është shërbimi programor me përmbajtje të shumëllojshme, i cili mund të jetë kombëtar, rajonal ose lokal.
- f. “Shërbim programor tematik” është shërbimi programor që të paktën 70% të kohës së transmetimit ia dedikon përmbajtjeve mbi një tematikë të caktuar: informacion; të mitur; kulturë dhe shkencë; filma; sport; shqip; muzikë, etj.
- g. “Shërbim programor për të mitur” është shërbimi programor tematik me përmbajtje që i dedikohen grupmoshës deri në 18 vjeç, me qëllim, informimin, edukimin dhe argëtimin, duke respektuar liritë dhe të drejtat e tyre.
- h. “Shërbim programor informativ” është shërbimi programor tematik me përmbajtje dedikuar informacionit, me lajme, rubrika të aktualitetit, kronika, reportazhe, debate dhe lidhje të drejtpërdrejta, biseda apo forume mbi aspekte të ndryshme të zhvillimit social, ekonomik, politik, kulturor etj.
- i. “Shërbim programor kulturë dhe shkencë” është shërbimi programor tematik me përmbajtje edukative, historike, artistike, letrare ose shkencore, dokumentarë dhe emisione të aktualitetit shkencor dhe teknologjik, me karakter argëtues, vepra audiovizive evropiane, pjesë teatrale, lirike etj.
- j. “Shërbim programor film” është shërbimi programor tematik i dedikuar për transmetimin e filmave artistikë, televizivë, seriale, etj.
- k. “Shërbim programor muzikë” është shërbimi programor tematik i dedikuar të gjitha rrymave krijuese e interpretuese, me përmbajtje të regjistruara ose live, informacion dhe diskutime mbi ngjarje muzikore nga vendi e bota etj.
- l. “Shërbim programor sport” është shërbimi programor tematik i dedikuar sportit, me ngjarje lokale, lokale dhe ndërlokale të transmetuara direkt ose të regjistruara, lajme dhe emisione diskutimesh nga zhvillime të ndryshme sportive.
- m. “Shërbim programor shqip” është shërbimi programor tematik me programe tërësisht në gjuhën shqipe, për nxitjen dhe promovimin e gjuhës e kulturës lokale, si filma, dokumentarë, përmbajtje zbavitëse e argëtuese etj.
- n. “Shërbim programor teleshitje” është shërbimi programor tematik që përbën një ofertë të drejtpërdrejtë për publikun për shitjen apo sigurimin e mallrave, shërbimeve ose pasurive të tjera të paluajtshme apo pronësisë intelektuale.

Neni 4

Shfrytëzimi i multipleksit

1. Mbajtësit e licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audiovizive janë të detyruar t'u japin akses në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese, në jo më pak se 40 për qind të kapacitetit të multipleksit të tyre, OSHMA-ve që zotërojnë licencë shërbimi programi audioviziv.
2. Mbajtësit e licencave rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv ofrojnë aksesin për transmetim në rrjetin numerik, mbi bazën e marrëveshjeve tregtare me OSHMA-të.
3. AMA siguron që të gjitha shërbimet që u ofrohen OSHMA-ve, që zotërojnë licencë shërbimi programi audio dhe ose licencë shërbimi programi audioviziv, nga mbajtësit e licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv, bazohen në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese.
4. Në rast mosmarrëveshjes midis OSHMA-ve dhe mbajtësve të licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve audioviziv, palët i drejtohen AMA-s.

KREU II

PROCEDURA E KONKURIMIT DHE DORËZIMIT TË APLIKIMIT PËR LICENCË

Seksion I

Kriteret për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv

Neni 5

Kërkesa të përgjithshme të aplikimit për licencë shërbim programi audioviziv

1. Aplikimi për marrjen e licencës lokale apo rajonale të shërbimit të programi audioviziv duhet të përmbajë:
 - a. Emërtimin, vendndodhjen, formën ligjore të subjektit që bën kërkesën bashkë me emrin dhe firmën e personit që ka të drejtë ta përfaqësojë atë.
 - b. Dokumentet që vërtetojnë të dhëna mbi kapitalin financiar të personit juridik që bën kërkesën.
 - c. Parashikimet për shpenzimet dhe të ardhurat, origjinën dhe shumën e financimeve të parashikuara për kohëzgjatjen për të cilën kërkohet licenca.
 - d. Emërtimin e programit.
 - e. Objektin dhe karakteristikat e përgjithshme të shërbimit, të dhëna për kohëzgjatjen e programeve dhe territorin që do të mbulojë, si dhe projektin teknik të instalimit dhe shfrytëzimit të aparaturave.
 - f. Mundësinë e ofrimit të mekanizmave për aksesimin e shërbimit nga individë me aftësi të kufizuar shqisore.
 - g. Listën e administratorëve,
 - h. Listën emërore të anëtarëve të bordit drejtues dhe *curriculum vitae* (jetëshkrimin) të tyre.

- i. Përmbajtjen e programeve që do të transmetohen dhe strukturën programore të propozuar për transmetim, të cilat të shprehin qartë pluralizmin në tërësinë e tyre dhe bazueshmërinë me kërkesat e ligjit nr. 97/2013, të ndryshuar.
- j. Dokumentacionin që vërteton të drejtën e transmetimit të programeve.
- k. Marrëveshje paraprake me mbajtësin e licencës për transmetime numerike lokale/rajonale ose me Radiotelevizionin Shqiptar, në rrjetin e të cilit do të mbështetet shërbimi i programit audioviziv.
- l. Aplikimi duhet të përfshijë informacion mbi strukturën e pronësisë së kompanisë dhe aksionarëve të saj.
- m. Subjekti aplikues duhet t'i përgjigjet çdo pyetjeje të autoritetit rregullator gjatë shqyrtimit të aplikimit.

Neni 6

Kërkesat ligjore

1. Licenca e shërbimit të programit audioviziv u jepet personave juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë si objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive.
2. Licenca e shërbimit të programit audioviziv nuk u jepet subjekteve që u është hequr ose u është bërë e pavlefshme licenca për ofrimin e shërbimeve audio/audiovizive, me vendim të AMA-s, nëse nuk ka kaluar të paktën një periudhë 10-vjeçare nga data kur i është hequr licenca e transmetimit. I njëjti kufizim zbatohet edhe ndaj subjekteve juridike, aksionarë të të cilëve janë individë që kanë qenë aksionarë në subjektet të cilëve iu është hequr licenca me vendim të AMA-s.
3. Licenca e shërbimit të programit audioviziv nuk u jepet personave të dënuar për një vepër penale, nëse nuk kanë kaluar 5 vjet nga përfundimi i këtij dënimi.
4. Në të njëjtën procedurë gare, të shpallur nga AMA sipas kësaj rregullore subjekti aplikues mund të marrë pjesë vetëm njëherë. Përfshirë këtu marrjen pjesë të subjekti edhe si palë ose nëpërmjet shoqërive të lidhura me të, shoqëri të kontrolluar, ortakëri, palë e kontraktuar apo nënkontraktor, ofrues shërbimi rrjeti ose pjesë të vet subjektit aplikues.
5. Mosrespektimi i kërkesave sipas këtij neni është kusht skualifikimi.

Neni 7

Kërkesat financiare

1. Licenca e shërbimit të programit audioviziv u jepet subjekteve që kanë kapital të deklaruar e të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në vlerën jo më pak se 3,500,000 lekë.
2. Subjekti aplikues për licencë për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv duhet të paraqesë garanci bankare në masën e pagesës vjetore të miratuar nga AMA për këtë licencë. Shuma e vendosur si garanci do të mbetet e ngurtësuar për një periudhë 9 mujore duke filluar nga data e depozitimit të aplikimit.
3. Garancia bankare ç'ngurtësohet menjëherë, para afatit, në rast se subjektit i është refuzuar aplikimi për licencë.
4. Në rast se aplikuesi pajiset me licencë, vlera e ngurtësuar kalon menjëherë për llogari të AMA-s si pagesë për vitin e parë të licencimit.

Neni 8

Kërkesat programore

1. Subjekti aplikues për licencë të shërbimit të programit audioviziv, duhet të garantojë, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, se në përmbajtjen e programeve të tij do të përmbushë standardet programore duke:

- a. Nxitur vlerat demokratike të përcaktuara në Kushtetutë dhe në veçanti të drejtën e shprehjes dhe të informimit;
- b. Respektuar pluralizmin e informacionit, paraqitjen e fakteve dhe ngjarjeve në mënyrë të ndershme, inkurajimin në formimin e lirë të opinioneve, pa i shërbyer në mënyrë të njëanshme interesave të asnjë partie, organizate politike, grupimi ekonomik apo komuniteti e shoqate fetare;
- c. Respektuar mirëkuptimin dhe bashkekzistencën shoqërore të të gjithë individëve në Republikën e Shqipërisë;
- d. Siguruar që përmbajta programore të pasqyrojë elementet përbërëse të kulturës kombëtare shqiptare dhe të gjuhës shqipe;
- e. Promovuar kulturën evropiane, të mbajë në konsideratë nevojën e formimit të opinionit publik për t'u njohur dhe për të kuptuar vlerat dhe traditat evropiane;
- f. Përfshirjen në strukturën programore të veprave evropiane;
- g. Promovuar kulturën e pakicave kombëtare;
- h. Ofruar mundësi për promovim të krijuesve të rinj në fushën e muzikës, shfaqjeve teatrore dhe sidomos ato të lidhura me kulturën kombëtare;
- i. Ofruar një shumëllojshmëri shërbimesh në territorin e RSH-së për kategoritë e ndryshme shoqërore, përfshirë këtu interesat e pakicave;
- j. Respektuar dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut;
- k. Respektuar privatësinë e individit;
- l. Respektuar diversitetin fetar dhe racën;
- m. Respektuar ruajtjen e sekretit të burimeve të informacionit;
- n. Respektuar normat morale dhe etike të shoqërisë;
- o. Respektuar të drejtën e përgjigjes.

Neni 8/1

Kërkesat teknike

1. Pajisjet teknike të përdorura duhet të jenë të pajisura me certifikime bazë të konformitetit European dhe ndërkombëtar (CE, EMC, Safety, RoHS), ndërsa standardet ETSI EN zbatohen vetëm për pajisjet e transmetimit dhe elementët e rrjetit, aty ku këto standarde janë teknikisht të aplikueshme.
2. Prodhimi dhe përpunimi i materialeve audiovizive duhet të realizohet në përputhje me standardet përkatëse sipas formatit të prodhimit dhe transmetimit, si më poshtë:
 - ITU-R BT.601 për format SD,
 - ITU-R BT.709 për format HD,
 - ITU-R BT.2100 për format UHD/HDR, si dhe në përputhje me rekomandimet përkatëse të Unionit European të Transmetimeve (EBU), aty ku aplikohen.
3. Për transmetimin dhe shpërndarjen e sinjalit audioviziv drejt publikut përdoren kodekë minimalë për video: H.264/AVC, H.265/HEVC, AV1, dhe për audio: AAC, MPEG Layer II, Dolby Digital Plus. Formatet, container-ët (p.sh. MXF) dhe kodekët e përdorur në fazat e

- brendshme të prodhimit, përpunimit teknik dhe transkodimit, përfshirë MPEG-2 ose formate të tjera ekuivalente, nuk përjashtohen, për sa kohë që sinjali i transmetuar drejt publikut përbush kërkesat e përcaktuara në këtë pike.
4. Subjekti duhet të garantojë një nivel minimal disponueshmërie të shërbimit prej 99.5% në periudhë vjetore, përveç ndërhyrjeve të planifikuara të miratuara nga AMA.
 5. Pajisjet kritike të transmetimit, përfshirë encoders dhe serverët kryesorë të shpërndarjes së sinjalit, duhet të funksionojnë në konfigurim N+1.
 6. Subjekti duhet të ketë në fuqi një Plan Rimëkëmbjeje nga Fatkeqësitë (DRP), i cili përcakton procedurat organizative dhe teknike për rikthimin e transmetimit të shërbimit audioviziv brenda një afati jo më të gjatë se 12 orë.
 7. Subjekti duhet të zbatojë masa të përshtatshme për sigurinë e informacionit dhe mbrojtjen e sistemeve teknike, duke garantuar kontrollin e aksesit, mbrojtjen e rrjetit dhe procedurat e rezervimit dhe rikuperimit të të dhënave.
 8. Mbrojtja e përmbajtjes audiovizive duhet të sigurohet përmes zbatimit të masave teknike të detyrueshme kundër përdorimit të paautorizuar, duke përfshirë DRM, ëatermarking statik ose dinamik dhe/ose mekanizma të tjerë funksionalë anti-pirateri, në përputhje me llojin e platformës së shpërndarjes dhe kapacitetet teknike të subjektit, si më poshtë:
 - a) për shërbimet IPTV dhe OTT, aplikimi i DRM;
 - b) për transmetimin linear tokësor, aplikimi i të paktën një mase teknike funksionale të mbrojtjes së përmbajtjes.
 9. Subjekti duhet të disponojë sistem monitorimi teknik të vazhdueshëm (24/7) të sinjalit audio/audioviziv, dhe të gabimeve kritike teknike përmes SNMP (Simple Network Management Protocol), syslog ose sistemeve teknike ekuivalente.
 10. Programacioni audioviziv duhet të arkivohet në formate të aksesueshme dhe për një periudhë kohore në përputhje me aktet rregullatore në fuqi, duke garantuar mundësinë e aksesit nga AMA sipas procedurave ligjore, përfshirë rregulloret të inspektimit.
 11. Dërgimi i sinjalit të programit drejt operatorit të rrjetit ose platformës përkatëse duhet të realizohet me metoda dhe protokolle të sigurta, duke synuar minimizimin e vonësive teknike në segmentin e transportit të sinjalit, në përputhje me kushtet teknike dhe infrastrukturën e përdorur.

Seksion II

Procedura e dorëzimit të aplikimeve

Neni 9

Çelja e garës

1. Subjektet e interesuara për licencë për shërbim programi audioviziv të mbështetur në rrjet numerik, paraqesin pranë AMA-s letrën e interesit, ku përshkruhet:
 - Natyra e shërbimit të kërkuar (shërbim programi audioviziv i përgjithshëm/tematik).
 - Emërtimi i shërbimit programor audioviziv që do të mbështetet në rrjetin numerik.
 - Prezantim i shkurtër i veprimtarisë së subjektit të interesuar.

2. AMA, me nismën e vet ose me kërkesën e subjekteve të interesuara sipas pikës 1 të këtij neni, duke marrë në konsideratë ekzistencën e kapaciteteve të lira teknike në rrjetet numerike të operatorit publik dhe operatorëve privatë:

- a. përcakton zonat përkatëse të mbulimit me programe, shërbime shoqëruese dhe të dhëna të tjera të lidhura me to.
- b. çel garën për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv.

Neni 10

Shpallja e procedurës së licencimit

1. AMA shpall publikisht çeljen e garës për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv në faqen e internetit të AMA-s, në tre nga gazetatat me tirazh më të lartë.
2. Njoftimi për shpalljen e garës përfshin ftesën e të gjitha palëve të interesuara për të shprehur propozimet e tyre, në lidhje me natyrën e transmetimit audioviziv, për të cilën është çelur gara. Në njoftim përcaktohen procedurat që duhen ndjekur për bërjen e aplikimit dhe kërkesat përkatëse.
3. Aplikimet për licencë bëhen brenda 40 ditëve nga shpallja e garës dhe duhet të përshkruajnë mënyrën e planifikuar të ofrimit të shërbimit dhe plotësimit të kritereve të shpallura paraprakisht nga AMA.

Neni 11

Tërheqja e dokumentacionit të konkurrimit

1. Subjektet e interesuara për t'u pajisur me licencë të shërbimit të programit audioviziv duhet të pajisen me dokumentacionin e licencimit dhe të paraqesin aplikimin përkatës në vendin, datën dhe orën e përcaktuar në njoftimin për shpalljen e garës.
2. Drejtoritë e AMA-s, përgatisin dokumentacionin që do t'u vihet në dispozicion subjekteve që do shfaqin interes për t'u licencuar, i cili mund të tërhiqet prej tyre pranë zyrës së protokollit të AMA-s, kundrejt tarifës së përcaktuar në vendimin për pagesa në AMA.

Neni 12

Sqarimet mbi dokumentacionin e licencimit

1. Jo më vonë se 20 ditë përpara përfundimit të afatit të dorëzimit të aplikimit, subjektet e që kanë blerë dokumentacionin e konkurrimit mund të kërkojnë sqarime me shkrim nga AMA për dokumentacionin e licencimit.
2. Sqarimet e bëra nga AMA mbi dokumentacionin e licencimit, pavarësisht kërkesës së një ose më shumë subjektsh, do t'u njoftohen të gjithë subjekteve që kanë blerë dokumentacionin e licencimit dhe do të publikohen në faqen zyrtare të AMA-s.

Neni 13

Aplikimi

1. Aplikimi duhet të përgatitet në përputhje me kërkesat e publikuara në dokumentacionin e licencimit të miratuar nga AMA, që do të jetë pjesë e dokumentacionit të licencimit.

2. Dokumentet e aplikimit, përfshirë dokumentet me vulë elektronike, që lëshohen nga institucionet shtetërore, duhet të jenë marrë jo më vonë se 40 ditë përpara datës së aplikimit.
 - 2.1 Aplikimi për licencë mund të dërgohet me postë, apo depozitohet dorazi në protokollin e AMA-s. Ai duhet të jetë i mbyllur në zarf, të jetë i vulosur, i firmosur dhe me mbishkrimin ku të saktësohet “Aplikim për marrje/rinovim/zgjerim ndryshim i kushteve të licence apo shërbim programi audioviziv”. Në të duhet të pasqyrohet në mënyrë të qartë, identiteti dhe adresa e saktë e aplikuesit.
3. Aplikimi duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i subjektit.
4. Dokumentacioni i aplikimit duhet të paraqitet origjinal ose i njësuar me të dhe nuk i kthehet aplikuesit.
5. Aplikuesi që ka depozituar aplikimin para afatit të dorëzimit, kundrejt një kërkesë, ka të drejtë t’a tërheqë atë, apo t’a plotësojë aplikimin, me përjashtim të ditës, që i korrespondon datës së hapjes së aplikimit. Në rast të tërheqjes të aplikimit të dorëzuar përpara afatit të përcaktuar si afat përfundimtar për dorëzimin e aplikimit, pagesa e kryer për përpunimin administrativ të aplikimit, i kthehet aplikuesit, në numrin e llogarisë bankare të tij.

Neni 14

Dokumentacioni i aplikimit

1. Subjekti aplikues për licencë shërbimi programi audioviziv duhet të plotësojë kërkesat për kualifikim si më poshtë:

1.1 Kërkesat juridike:

- a. Regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me gjithë ndryshime (nëse ka), forma ligjore, emërtimi, vendndodhja e subjektit, lista e aksionarëve me aksionet/kuotat përkatëse respektive me status aktiv, bashkë me emrin dhe firmën e personit, që ka të drejtë ta përfaqësojë atë, kur nuk përfaqësohet direkt nga përfaqësuesi ligjor, lëshuar jo më vonë se 40 ditë nga paraqitja e aplikimit.
- b. Në rastin kur njëri nga ortakët e subjektit aplikues është person juridik duhet të paraqesë Ekstraktin për të dhënat e tij dhe listën e ortakëve të tij.
- c. Deklaratë noteriale të secilit prej aksionarëve të subjektit aplikues, lidhur me aksionet/kuotat e zotëruara prej tyre në shoqëri të tjera me veprimtari audio ose audiovizive, dhe në rast se aksionari/ortaku i subjektit është person juridik, kjo deklaratë noteriale nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i subjektit aksionar/ortak i shoqërisë aplikuese.
- d. Vërtetim i gjendjes gjyqësore të aksionarëve/ortakëve të subjektit.
- e. Adresa, nr. tel, fax, email.
- f. Personi përfaqësues.
- g. Deklaratën për vërtetësinë e të dhënave të paraqitura.

1.2.Kërkesa teknike:

- a. Përshkrim të përgjithshëm të shërbimit, duke përcaktuar, përveç të tjerash, multipleksin ku do të mbështetet shërbimi i programit audioviziv, si dhe kapacitetin e dakordësuar midis palëve, të parashikuar në marrëveshjen paraprake me mbajtësin e licencës numerike të transmetimit.

- b. Projektin e studios së prodhimit, shoqëruar me bllok-skema funksionale të organizimit të studios dhe të kalimit të sinjalit në fazat kryesore të prodhimit dhe përpunimit, si dhe me përshkrimin e kushteve bazë teknike të mjedisit të prodhimit, përfshirë masat e izolimit akustik dhe ndriçimin profesional.
- c. Listën e pajisjeve teknike që do të përdoren për ofrimin e shërbimit, duke përfshirë tipin, modelin, prodhuesin, parametrat teknikë, vendndodhjen dhe dokumentet e përputhshmërisë (CE, EMC, RoHS).
- d. Përshkrimin e standardeve të sinjalit audio dhe audioviziv për prodhimin dhe transmetimin, duke përfshirë formatet (SD/HD/UHD), kodekët, frame rate, profilin e kompresimit dhe kërkesat për cilësinë e audios sipas standardit EBU R128.
- e. Përshkrimin e masave bazë teknike dhe organizative për mbrojtjen e sistemeve dhe përmbajtjes audiovizive, përfshirë, sipas rastit, kontrollin e aksesit, mbrojtjen bazë të rrjetit, enkriptimin e sinjalit kur është teknikisht i aplikueshëm, mekanizma për mbrojtjen e përmbajtjes (si DRM ose ëatermarking) dhe procedurat për kopjimin rezervë dhe rikuperimin e të dhënave.
- f. Përshkrimin e sistemit të monitorimit teknik të funksionimit të sinjalit, duke përfshirë mjetet ose pajisjet e përdorura për monitorim të vazhdueshëm, dokumentimin e parametrave kryesorë teknikë dhe mënyrën e ruajtjes së të dhënave të monitorimit.
- g. Përshkrimin e mënyrës së dërgimit të sinjalit te operatori i rrjetit, duke specifikuar llojin e lidhjes (fibër optike, IP, SRT, RIST, mikrovalë), protokollet e transportit, garancitë e stabilitetit dhe nivelin e latencës së pranueshme.
- h. Planin e masave për vazhdimësinë teknike të transmetimit, duke përfshirë pajisjet rezervë dhe zgjidhjet e arsyeshme për minimizimin e ndërprerjeve, të përshtatura me përmasën dhe strukturën e aktivitetit të subjektit.

1.3.Kërkesat ekonomike:

- a. Të dhëna për kapitalin e deklaruar dhe të nënshkruar të shoqërisë, i cili duhet të jetë i pasqyruar dhe i depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Biznesi plani me treguesit e tij dhe analizat përkatëse për periudhën e vlefshmërisë së licencës (a. përshkrimi i shoqërisë, b. analiza e tregut, c. strategjia e marketingut, d. burimet e financimit dhe objektivat financiare);
- b. Garancia bankare që vërteton se aplikuesi ka ngurtësuar shumën, në vlerën e masës së pagesës vjetore për licencë, me afat deri në 9 muaj, duke filluar nga data e paraqitjes së aplikimit;
- c. Parashikimet për shpenzimet dhe të ardhurat, burimet dhe shumën e financimeve të parashikuara për kohëzgjatjen për të cilën kërkohet licenca;
- d. Lista e administratorëve.

1.4.Kërkesat programore:

- a. Përmbajtja e programeve që do të transmetohen dhe strukturën programore të propozuar për transmetim, të cilat të shprehin qartë pluralizmin në tërësinë e tyre dhe paanësinë e informacionit.

- b. Të dhëna statistikore për programet audioviziv të katalogut të shërbimit programor të përgjithshëm dhe tematike (Informacion, kulturë, art, argëtim, zbavitje, radio-dramatizim, sport, emisione për fëmijë, reklamë, etj.)
- c. Të dhëna për kohëzgjatjen e programeve;
- d. Programi javor i transmetimit;
- e. Përshkrim i shkurtër i përmbajtjes së programeve kryesore të prodhuara vetë.

1.5.Kërkesat për të drejtën e transmetimit:

- a. Depozitimi i kontratave ose marrëveshjeve paraprake me mbajtësit e të drejtave të përmbajtjes që do të transmetohen dhe ritransmetohen.

1.6.Kërkesat organizative:

- a. Të dhëna mbi numrin e punonjësve që parashikon të punësojë jo më i vogël se 10 (dhjetë).
- b. Organizimi dhe drejtimi i shoqërisë, lista dhe CV-të e anëtarëve të Bordit (minimumi 9 anëtarë);
- c. Nëse subjekti aplikues ushtron aktivitet audioviziv, vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe/ose Drejtoria e Tatimeve mbi numrin e punonjësve të siguruar të aplikuesit si dhe listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të subjektit për 12 muajt e fundit nga paraqitja e aplikimit.

2. Deklarimet e subjektit aplikues mbi plotësimin e kërkesave të parashikuara në këtë nen do të jenë pjesë e kushteve të licencës, mospërmbushja e të cilave do të përbëjë shkak për heqjen e saj.
3. Subjekti aplikues duhet t'i përgjigjet çdo pyetjeje të autoritetit rregullator gjatë shqyrtimit të aplikimit.
4. Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme është kusht skualifikues.

Seksion III Shqyrtimi dhe vendimmarrja mbi aplikimet

Neni 15 Shqyrtimi i aplikimeve

1. Shqyrtimi i aplikimeve për marrje licence, rinovim, zgjerim ose ndryshim të zonës së mbulimit, kryhet nga Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit, i ngritur me urdhër të kryetarit të AMA-s.
2. Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit përbëhet si më poshtë:
 - Drejtori i Drejtorisë Ligjore
 - Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit të Frekuencave dhe Teknologjisë së Informacionit
 - Drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve
 - Drejtori i Drejtorisë së Monitorimit dhe Analizës
 - Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Arkivë-Protokoll
 - Drejtori i Drejtorisë së Inspektimit dhe Mbikëqyrjes

3. Në rastet e aplikimit për marrje licence shërbim programi audioviziv dhe zgjerim ose ndryshim të zonës së mbulimit, mbledhjet e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit drejtohen nga Zv/Kryetari në cilësinë e Kryetarit të Komisionit, pa të drejtë vote, me pjesëmarrjen e të paktën një prej anëtarëve të AMA-s.
4. Anëtarët e Komisionit shqyrtojnë dhe verifikojnë përmbushjen e kriterëve ligjore, ekonomike, teknike, programore, të së drejtës së transmetimit dhe organizative, dhe përgatisin relacionet e vlerësimit sipas kompetencës. Në rastet aplikimit të marrjes licencës, zgjerimit ose ndryshimit të zonës rezultatat e vlerësimit me pikë i paraqiten AMA-s në një raport të shoqëruar nga një tabelë përmbledhëse ku aplikuesit renditen sipas numrit maksimal të pikëve të grumbulluara.
5. AMA miraton procedurat e ndjekura dhe vlerësimin me pikë në një mbledhje të veçantë. AMA në rast se konstaton mangësi në respektimin e procedurave dhe vlerësimit, ka të drejtë të drejtë të kërkojë kryerjen e një vlerësimi të ri.
6. Anëtarët e Komisionit mbajnë përgjegjësi për saktësinë e përpunimit të të dhënave të akteve të sipërcituara, si dhe për ruajtjen e konfidencialitetit të informacioneve me të cilat njihet gjatë këtij procesi.
7. Informacionet në lidhje me shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve nuk duhet t'u bëhen të njohura aplikuesve a personave të tjerë, që nuk janë të angazhuar zyrtarisht në këtë proces.

Neni 15/1

Procedura e shqyrtimit të aplikimit

1. Aplikimet për marrje licence transmetimi audioviziv, zgjerim të zonës së mbulimit dhe rinovimin e licencës, administrohen në prani të të gjithë anëtarëve të Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit. Komisioni bën verifikimin nëse dosjet e aplikimit janë të mbyllura, të firmosura e të vulosura. Anëtari i Komisionit të Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve verifikon nëse subjekti ka kryer Pagesën për Përpunimin e Dokumentacionit dhe njofton Komisionin. Në rast se subjekti nuk e ka paguar PPD, dosja e aplikimit të subjektit nuk i nënshtrohet shqyrtimit, dhe arkivohet.
2. Pasi lexohet me zë të lartë subjekti aplikues, vijon identifikimi i gjithë dokumentacionit që përmban dosja e aplikimit.
3. Komisioni, pas hapjes së dosjes së aplikimit, verifikon paraprakisht nëse dokumentacioni i aplikimit i paraqitur nga subjektet që kërkojnë të pajisen me licencë është në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje. Në rast se dokumentacioni nuk është konform akteve të sipërpërmendura, subjekti aplikues skualifikohet dhe aplikimi i tij, pavarësisht vlerësimit nga anëtarët e KSHD-së, nuk i nënshtrohet vlerësimit me pikë.
4. Aplikimi i subjektit, për marrje licence transmetimi audioviziv, dokumentacioni i të cilit, rezulton në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje, shqyrtohet në mënyrë tërësore nga anëtarët e KSHD-së dhe i nënshtrohet vlerësimit me pikë.
5. Relacionet e vlerësimit përgatiten dhe i dorëzohen Drejtorisë Ligjore, jo më vonë se 3 ditë nga marrja në dorëzim të dosjes së aplikimit përkundrejt nënshkrimit në procesverbalin e vlerësimit të aplikimit.
6. Pas mbledhjes së relacioneve të vlerësimit të të gjithë anëtarëve, Drejtoria Ligjore përgatit relacionin përmbledhës, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit, një kopje e të cilit i përcillet Kryetarit të AMA-s.
7. Relacioni përfundimtar përmbledhës i vlerësimit, së bashku me gjithë praktikën e subjektit aplikues, si dhe propozimi përkatës i Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit në lidhje

- me aplikimin e subjektit, i paraqiten AMA-s në mbledhje për vendimmarrje.
8. AMA miraton procedurën e ndjekur të vlerësimit dhe në rast se konstaton mangësi në respektimin e tyre, ka të drejtë të kërkojë kryerjen e një vlerësimi të ri.
 9. Në rast se në përfundim të procesit të vlerësimit, rezulton se dy ose më shumë subjekte aplikues, për të njëjtën zonë ofrimi shërbimi, do të rezultojnë me pikë të njëjta, AMA ka të drejtë të japë licencën përmes procedurës me short, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të subjekteve aplikues që do të jenë subjekt i shortit.
Përfaqësuesit e subjekteve aplikues njoftohen të marín pjesë në datën, kohën dhe vendin e përcaktuar nga AMA nëpërmjet shërbimit postar rekomande:
Procedura e shortit:
 - a) Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit me vendim për zhvillimin e shortit, cakton datën, orën dhe vendin, si dhe njofton zyrtarisht subjektet pjesëmarrëse;
 - b) Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit përgatit fletë/gogla me emrat e subjekteve, ku sigurohet barazia (madhësia, forma, mënyra e vendosjes);
 - c) Kryetari i komisionit shpjegon procedurën, hedhja e shortit bëhet manualisht, përzgjidhet subjekti fitues, rezultati shpallet menjehere dhe publikohet në faqen zyrtare të institucionit.Në përfundim të procedurës së hedhjes së shortit përpilohet procesverbali me datën dhe vendin, emrat e pjesëmarrësve, përshkrimin e procedurës, dhe rezultatin përfundimtar. Procesverbali nënshkruhet nga komisioni (KSHD) dhe nga përfaqësuesit e subjekteve. Mungesa e përfaqësuesve të OSHMA nuk do të pengojë vazhdimin e procedurës së shortit.
 10. Gjatë procedurës së shqyrtimit të dosjeve të aplikimit mbahet procesverbal, nga sekretari i AMA-s, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit.

Neni 16

Vendimmarrja

1. Vendimi për dhënien ose mosdhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv jepet nga AMA jo më vonë se 60 ditë nga dita e aplikimit, duke filluar ky afat nga data e përcaktuar për depozitimin e aplikimit.
2. Kur AMA vendos mosmiratimin e aplikimit, duhet të njoftojë aplikuesit për:
 - a) arsyet e vendimit;
 - b) rezultatin e vlerësimit të aplikuesit;
 - c) rezultatin e aplikimit fitues.
3. Kundër vendimit të AMA-s sipas këtij neni, aplikuesi mund të bëjë ankim në gjykatë, në përputhje me rregullat e parashikuara nga ligji për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative duke filluar ky afat nga momenti i marrjes dijeni.
4. Kërkesat e parashikuara në pikat 1 të këtij neni nuk zbatohen në rastin e aplikimit për rinovimin e licencës së shërbimit të programit audioviziv. Në këtë rast AMA vendos për aplikimin e depozituar brenda 30 ditëve nga depozitimi i aplikimit, të plotësuar me të gjitha kërkesat ligjore dhe ato të kësaj rregulloreje, për rinovim.
5. Rrëzimi i aplikimit për mosrinovim të licencës së shërbimit të programit audioviziv, dhe zgjerim të zonës së mbulimit, bëhet gjithmonë kundrejtë një vendimi të arsyetuar brenda 30 ditëve.

Seksion IV
Kriteret e vlerësimit të aplikimeve, rinovimi, zgjerimi dhe
reduktimi i zonës së mbulimit

Neni 17
Kriteret e Vlerësimit me pikë të aplikimeve për licencë transmetimi

Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit bën vlerësimin me pikë të çdo aplikimi për licencë të shërbimit të programit audioviziv duke u mbështetur në këto kritere:

1. Struktura programore

1.1 Program i përgjithshëm 75 (pikë)

1.1.1 Vlerësimi i shërbimit programor 40 (pikë)

Programe informative	10 pikë
Programe për të mitur	10 pikë
Programe kulturë	7 pikë
Programe sportive	5 pikë
Filma	4 pikë
Programe Muzike	4 pikë

Vlerësimi për secilën nga tematikat e mësipërme do të jetë si më poshtë:

Subjekti aplikues që rezulton me kohën më të gjatë të transmetimit të tematikës përkatëse vlerësohet me pikët maksimale. Vlerësimi i aplikuesve të tjerë do të llogaritet me përqindjen që koha e transmetimit të tyre zë në raport me kohën e aplikuesit me rezultat maksimal.

1.2. Program tematik: 75 (pikë)

1.2.1 Vlerësimi i tematikës sipas shërbimit programor 40 (pikë)

a. Të mitur	40 pikë
b. Informative	37 pikë
c. Kulturë dhe Shkencë	34 pikë
d. Filma	31 pikë
e. Sport	28 pikë
f. Shqip	25 pikë
g. Muzikë	22 pikë
h. Programe të tjera	19 pikë për çdo program

Në rast se për të njëjtën tematikë shërbimi programor janë depozituar dy ose më shumë aplikime vlerësimi do të kryhet si më poshtë:

Subjekti aplikues që rezulton me përqindjen më të lartë të kohës së transmetimit (referuar përkufizimit minumimi është 70%) do të vlerësohet me pikët maksimale. Vlerësimi i aplikuesve të tjerë do të llogaritet me përqindjen që koha e transmetimit të tyre zë në raport me kohën e aplikuesit vlerësuar me pikët maksimale.

1.2.2 Programe të realizuar vetë

20 (pikë)

Vlerësimi për secilin aplikues do të jetë si më poshtë:

Subjekti aplikues që rezulton me kohën më të gjatë të transmetimit të programeve të realizuara vetë vlerësohet me pikët maksimale. Për aplikuesit e tjerë vlerësimi bëhet me përqindjen që koha e transmetimit të tyre zë në raport me kohën e aplikuesit me rezultat maksimal.

1.2.3 Programe në gjuhën shqipe

15 (pikë)

Vlerësimi për secilin aplikues do të jetë si më poshtë:

Subjekti aplikues që rezulton me kohën më të gjatë të transmetimit të programeve në gjuhën shqipe vlerësohet me pikët maksimale. Për aplikuesit e tjerë vlerësimi bëhet me përqindjen që koha e transmetimit të tyre zë në raport me kohën e aplikuesit me rezultat maksimal.

2. Vlerësimi i aftësive teknike

10 (pikë)

2.1. Cilësia e programit që do mbështetet në rrjetet numerik (HD dhe SD)

Subjekti aplikues që do të prodhojë programe në formatin HD

6 (pikë)

Subjekti aplikues që do të prodhojë programe në formatin SD

4 (pikë)

3. Vlerësimi i kriterëve financiarë

10 pikë

3.1. Kapaciteti mesatar i vetëfinancimit për periudhën e vlefshmërisë së licencës 10 pikë

3.2. Kapaciteti mesatar i financimit nga palë të treta (kredi bankare ose palë të lidhura me subjektin) për periudhën e vlefshmërisë së licencës 7 pikë

4. Vlerësimi i burimeve njerëzore

5 pikë

- Numri i punonjësve të punësuar

5 pikë

Subjekti aplikues që rezulton me numrin mesatar më të lartë të punonjësve do të vlerësohet me pikët maksimale. Për aplikuesit e tjerë, vlerësimi bëhet me përqindjen që numri i punonjësve të tyre zë në raport me numrin e punonjësve të aplikuesit me rezultat maksimal.

Neni 17/1

Rinovimi i licencës së shërbimit të programit audioviziv

1. Aplikimi për rinovimin e licencës së shërbimit të programit audioviziv lokal dhe rajonal duhet të bëhet të paktën 90 ditë përpara përfundimit të afatit të licencës.

2. AMA gjatë shqyrtimit të aplikimit për rinovimin e e licencës së subjektit të pajisur me licencë lokale dhe rajonale të shërbimit të programit audioviziv verifikon respektimin e kushteve

teknike, juridike, organizative, financiare, e programore për periudhën që ka ushtruar veprimtari audiovizive.

3. Kërkesat e aplikimit për rinovimin e licencës për shërbimin e programit audioviziv lokal dhe rajonal janë të njëjta me atë të aplikimit për marrje licence të shërbimit të programit audioviziv lokal dhe rajonal.

4. Kërkesat teknike të përcaktuara në pikën 1.2, të nenit 14, të kësaj rregulloreje janë të detyrueshme dhe do të zbatohen dhe në rastet:

- a) rinovimit të licencës së shërbimit të programit audioviziv;
- b) ndryshimit të kushteve të licencës së shërbimit të programit audioviziv. Subjekti i cili kërkon të ndryshojë kushtet e licencës për shërbimin e programit audioviziv depoziton pranë AMA-s, kërkesën e arsyetuar.

5. Aplikimi për rinovimin e licencës së shërbimit të programit audioviziv lokal dhe rajonal nuk i nënshtrohet vlerësimit me pikë. Në rastin e mungesave në dokumentacion apo parregullsi të konstatuara në dokumentacionin e aplikimit për rinovimin e licencës, Kryetari i AMA-s, pas propozimit të Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, vendos t'i caktojë një afat të ri subjektit aplikues për rinovimin e licencës për shërbimin e programit audioviziv lokal dhe rajonal, për plotësimin e mangësive apo parregullsive të konstatuara në dokumentacion, por duke mos tejkaluar afatin e përfundimit të licencës.

6. AMA gjatë procesit të rinovimit të licencës verifikon edhe:

6.1 Respektimin e kushteve të mëparshme të licencës, ku përfshihen:

- a) realizimi i mbulimit të zonës së licencimit (sipas territorit dhe sipas popullsisë);
- b) respektimin e kushteve të licencës për sa i përket programeve, formati dhe struktura programore;
- c) Respektimin e të drejtave të transmetimit dhe autorit.

6.2 Detyrimet financiare për periudhën e ushtrimit të aktivitetit ku përfshihen:

- a) pagesa vjetore për licencë përtej vitit kalendarik në të cilin bëhet shqyrtimi i aplikimit për rinovim licence;
- b) pagesa për tarifën e shërbimeve audiovizive përtej vitit kalendarik në të cilin bëhet shqyrtimi i aplikimit për rinovim licence;
- c) ecuria e ekzekutimit të sanksioneve me gjobë të vendosura nga AMA të kthyer në titull ekzekutiv.

7. AMA refuzon aplikimin e subjektit i cili nuk ka përmbushur pikat 4 dhe 6 të këtij neni.

Neni 17/2

Zgjerimi dhe reduktimi i zonës së mbulimit

1. Kërkesat e aplikimit për zgjerimin e zonës së licencimit për shërbimin e programit audioviziv janë të njëjta me atë të aplikimit fillestar për marrje licence të shërbimit të programit audioviziv lokal/rajonal (vetëm për zonën e zgjerimit).

2. Subjekti aplikues në rast zgjerimi ose reduktimi të zonës së shërbimit të programit audioviziv duhet të dorëzojë dokumentacionin teknik të përditësuar për përshkrimin e mënyrës së dërgimit të sinjalit, në gjendjen aktuale dhe çdo ndryshim nga kushtet teknike të miratuara nga AMA.

2. I licencuari për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të programit audioviziv, duhet të fillojë transmetimin 9 muaj pas hyrjes në fuqi të vendimit për zgjerim, të kundërt, AMA, do të procedojë duke e bërë atë të pavlefshëm.

KREU III DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 18

Afati i licencës së shërbimit të programit audioviziv

Licenca lokale/rajonale e shërbimit të programit audioviziv jepet për një afat 8 vjeçar.

Neni 19

Detyrimi për daljen në transmetim

I licencuari për transmetim audioviziv lokal/rajonal, duhet të fillojë transmetimin 9 muaj pas hyrjes në fuqi të vendimit për dhënie licence, kërkesë e parashikuar në nenin 69 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 20

Detyrimet financiare

1. Pagesat për marrjen e licencës, rinovimin, zgjerimin, reduktimin dhe ndryshimin e kushteve të licencës, pagesat vjetore të licencës, pagesat për përpunimin e dokumentacionit, do të kryhen bazuar në vendimin e AMA për pagesat për licencë dhe pagesë për shërbimet që kryhen nga AMA.
2. Pagesa vjetore për licencë për vitin e parë të licencimit, mbahet nga vlera e ngurtësuar për llogari të AMA-s, në përputhje me nenin 7 të kësaj rregullore.
3. Pagesa vjetore për licencë, kryhet brenda tremujorit të parë të vitit kalendarik. Në rastin kur pagesa kryhet pas kalimit të këtij afati, aplikohet një kamatë vonesë në masën 0.1% të vlerës së pagesës vjetore për çdo ditë vonesë por jo më shumë se 30% e vlerës së detyrimit financiar.

Neni 21

Hyrja në fuqi

1. Neni 8/1, për OSHMA-të që aplikojnë për rinovim të licencës, hyn në fuqi 4 (katër) vite nga data e miratimit të kësaj rregulloreje. Për subjektet që kanë aplikuar për marrje licence deri në datën e miratimit të kësaj rregulloreje nuk do t'i nënshtrohen nenit 8/1 të kësaj rregulloreje.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të AMA-s.